



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 20.02.2025 | Nr: 131 | Ora: 12: 00

VENDIM

PËR

**FILLIMIN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE BAZUAR NË DENONCIMIN
NR. 32 ID, DATË 18.02.2025, TË REGJISTRIT TË DENONCIMEVE, TË PARTISË
DEMOKRATIKE/PD**

Sot më datë 20.02.2025, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi mori në shqyrtim paraprak denoncimin me:

KËRKUES: Partia Demokratike

SUBJEKT: **Z. Armando Subashi**
Kryetar i Bashkisë Fier

Zj. Eriselda Sefa
Kryetar i Bashkisë Lushnjë

Zj. Majlinda Bufi
Kryetare e Bashkisë Roskovec

Zj. Belinda Balluku
Zv. Kryeministër dhe Ministër i Energjisë dhe Infrastrukturës

Zj. Ogerta Manasterliu
Ministër i Arsimit dhe Sportit

Zj. Mirela Kumbaro
Ministër i Turizëm dhe Mjedisit

Z. Bledar Çuçi
Zv. Kryetar i Kuvendit të Shqipërisë

OBJEKT: Konstatim i kryerjes së veprimtarive të ndaluara, nga neni 91 i Kodit Zgjedhor dhe Vendimi nr. 9/2020 i Komisionit Rregullator, nëpërmjet përdorimit të burimeve njerëzore dhe regjistrimit në PER të zgjedhësve.

BAZA LIGJORE: Neni 91, pikat 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, dhe 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, neni 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 09.03.2021, të Komisionit Rregullator.

K O N S T A T O J :

Partia Demokratike më datë 18.02.2025, ka paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) nëpërmjet adresës së postës elektronike e-mail, denoncimin e administruar në regjistrin e denoncimeve me nr. 32 ID.

Në këtë denoncim Partia Demokratike parashtrohet sa vijon:

“Partia Demokratike ka marrë dijeni nëpërmjet emisionit investigativ “Piranjat” në puntatën e datës 8.02.2025, se disa funksionarë të shtetit të Partisë Socialiste, kanë marrë pjesë në një takim të organizuar në Athinë, me shqipëtarë që jetojnë atje. Shqipëtarët që jetojnë në Greqi, kanë deklaruar para kamerave se i janë kërkuar mjetet e identifikimit për të kryer regjistrimin në PER si dhe i janë bërë foto për këtë qëllim, nga persona që kanë ardhur posaçërisht në takim nga Tirana.

Për sa më sipër, personat e përfshirë në këtë takim për shkak të funksionit që kryejnë në administratë konsiderohen burime njerëzore. Për këtë arsye, vlerësojmë se organizimi i këtij takimi, marrja e mjeteve të identifikimit, përdorimi i tyre për qëllime të jashtëligjshme dhe regjistrimi në PER i zgjedhësve janë veprime të kryera në shkelje të nenit 91 të KZ dhe vendimit nr. 9/2020 të Komisionit Rregullator.”

Nga sa më sipër çmohet se, ekzistojnë kushtet për t’u nisur hetimi administrativ.

P Ë R K Ë T O A R S Y E :

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve,

V E N D O S :

1. Fillimin e procedurës administrative ndaj:

- Z. Armando Subashi, Kryetar i Bashkisë Fier;
- Zj. Eriselda Sefa, Kryetar i Bashkisë Lushnjë;
- Zj. Majlinda Bufi, Kryetar i Bashkisë Roskovec;

- Zj. Belinda Balluku, Zëvendës Kryeministër dhe Ministër i Energjisë dhe Infrastrukturës;
 - Zj. Ogerta Manasterliu, Ministër i Arsimit dhe Sportit;
 - Zj. Mirela Kumbaro, Ministër i Turizëm dhe Mjedisit;
 - Z. Bledar Çuçi, Zëvendës Kryetar i Kuvendit të Shqipërisë.
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve nëpërmjet adresës së postës elektronike.
 3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI